Ditari Natyrës

Nr. 35 Viti i katërt i botimit Prill 2016

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- INCA e ftuar në panairet IPA
- Vazhdon proçesi i zonimit të Liqenit të Shkodrës
- Një ditë në Parkun Tim
- Mbahet në Shkodër Forumi i hapur Qytetar / nga Mahir Hoti, FSLSH, Shkodër
- Pyjet, pemët dhe shëndeti i njeriut / nga Gjon Fierza
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se 13 vjet më parë ...

...1 - miratohet **VKM nr.266, datë 24.04.2003** "Për administratat e zonave të mbrojtura", sipas këtij vendimi duhet të krijohen administratat e mbrojtjes së ZM. Numri i punonjësve të administratës, për secilën zonë, caktohet në përputhje me statusin, nivelin e saj të mbrojtjes. Administrata e zonës së mbrojtur përgjigjet edhe për monumentet e natyrës, që ka rrethi, pavarësisht nëse ato ndodhen ose jo në territorin e zonës së mbrojtur. Gjithashtu, përcaktohen detyrat dhe shërbimet që duhet të kryejë Administrata e zonës së mbrojtur.

Vijon në faqe 2

Liqeni i Shkodrës © Foto INCA

Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës

Adriatiku GreenClean PSEDA - ILIRIA RRJETI PËR MBROJTJEN E NATYRËS Shoqata Mjedisore Cajupi Bashkejeto me Natyrën

Vijon nga faqe 1

...2 - me **VKM nr.267, datë 24.04.2003** miratohen "Proçedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike", ndër të tjera theksohet: Çdo organ e institucion shtetëror, qëndror ose vendor, person juridik ose fizik, shoqatë jo fitimprurëse ose komunitet, ka të drejtë të paraqesë në Ministrinë e Mjedisit propozime për shpalljen e zonave të mbrojtura, për ndryshimin ose heqjen e statusit të çdo zone të mbrojtur, për zgjerimin ose zvogëlimin e kufijve të zonës dhe për zonimin e brendshëm të tyre... Për shpalljen e zonave të mbrojtura merret parasysh rrjeti i zonave të mbrojtura, i paraqitur në strategjinë dhe planin e veprimit për biodiversitetin....Për shpalljen e një zone të mbrojtur përcaktohen, paraprakisht, statusi i saj, kufij të dhe zonimi i brendshëm, zona buferike rreth saj, administrata e ruajtjes së zonës dhe varësia e saj, mundësitë e përpunimit e të shfrytëzimit të zonës, të ardhurat që mund të krijohen dhe përdorimi i tyre në dobi të zonës, në bazë të studimeve rajonale...

...7 vjet më parë ...

...miratohet **ligji nr.10120, datë 23.04.2009** "Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore". Ky ligj ka për qëllim të mbrojë: a) fondin e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, që rriten e zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke zbatuar masa mbrojtëse e administruese, tërësore për fondin e të veçanta për çdo lloj, duke respektuar kërkesat teknike për vjeljen e mbledhjen e tyre, duke nxitur e përkrahur veprimtaritë për rehabilitimin e për kultivimin e tyre; b) llojet e kultivuara nga njeriu, në sipërfaqet e fondit të tokave pyjore, kullosore apo bujqësore, gjatë kultivimit, mbledhjes e vjeljes së tyre, si dhe llojet e kultivuara në parcela eksperimentale, në kuadër të veprimtarive kërkimore-shkencore; c) fondin e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, që rriten e zhvillohen në gjendje natyrore në territorin e Republikës së Shqipërisë e që është pasuri kombëtare.

Objekt i këtij ligji është tërësia e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, si dhe secili lloj, që përfshihet në fond, gjatë periudhës së rritjes, vjeljes e mbledhjes, si dhe gjatë magazinimit e transportimit të tyre, për t'ua ruajtur vlerat përdoruese e kurative të tyre.

...6 vjet më parë ...

...1 - bazuar në studimin dhe rekomandimet e planit të meanxhimit, të hartuar në kuadër të projektit "Menaxhimi i integruar i ujërave dhe i ekosistemeve", në kuadër të hartimit të Planit të Menaxhimit për nën komponentin e ekosistemit "Kune-Vain-Tale", me **VKM nr. 432, datë 28.04.2010,** u bë zgjermi i sipërfaqes së Rezervatit Natyror të Menaxhuar "Kune-Vain-Tale, me 4,393.2 ha. Sipërfaqja e zgjeruar përfshin territoret e Shëngjinit, Kune-Merxhanit, Vainit, Tales deri në grykëderdhjen e Lumit Mat. Për këtë RNM ka përfunduar dhe është miratuar, me urdhërin nr.405, datë 09.06.2011të Ministirit të Mjedisit, plani i menaxhimit...

...2 - shpalljen e ekosistemit natyror detar, pranë gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit, "Park Kombëtar Detar", me sipërfaqe të përgjithshme 12,570.82 ha, me **VKM nr. 289, datë 28.04.2010.** Është i pari Park Detar i Shqipërisë. Aktualisht, për këtë park ka përfunduar dhe është miratuar, me urdhërin e nr. 750, datë 24.11.2015 të Ministirit të Mjedisit, plani i menaxhimit, i përgatitur nga INCA, me mbështetje të UNDP, ku janë zhvilluar një gamë e gjerë veprimtarish.

Po kështu, INCA, në bashkëpunim me zyrën për Mesdheun të Fondit Botëror përJetën e Egër (WWF MedPO), vijon punën për zbatimin e projektit "Mbështetje e aktiviteteve

Vijon në faqe 3

Vijon nga faqe 2

të qëndrueshme ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare - Projekti për Shqipërinë'', i cili financohet nga Fondi i Partneritetit për Ekosistemet në gjendje kritike (CEPF) dhe është pjesë e një nisme rajonale Mesdhetare (Sustainable Economic Activities in Mediterranean Marine Protected Areas - SEA-Med), e cila zbatohet në 8 zona të mbrojtura detare të Libisë, Tunizisë, Turqisë, Kroacisë, Algjerisë dhe Shqipërisë. Projekti, ndër të tjera, synon të mbështesë zhvillimin e turizmit në PKD "Karaburun-Sazan'', në bashkëpunim të ngushtë me aktorët lokal dhe partnerët e projektit si Administrata e PKD, Bashkia Orikum, Universiteti i Vlorës, OJF-t mjedisore, komunitetin e biznesit, komunitetin, Këshilli i Qarkut Dibër, me vendimin ***nr.16, datë 03.04.2013,*** *shpalli Liqenin e Ulëzës dhe zonën rreth tij, me sipërfaqe 4,206.0ha, "Park Natyror Rajonal''.*

Parku Rajonal i Ulzës, përbën shëmbullin e parë në vendin tonë, të kësaj përqasjeje të re, për t'i sjellë zonat e mbrojtura më afër komunitetit dhe autoriteve vendore, të cilët duhet të marrin përgjegjësitë dhe të kontribuojnë për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të natyrës e biodiversitetit në vend.

Për miratimin e tij një kontribut të rëndësishem ka dhë në Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA).

...3 vjet më parë ...

...bazuar në dispozitat e ligjit "Për zonat e mbrojtura'' dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave VKM nr.519, datë 30.06.2010 "Proçedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të Parqeve Natyrore Rajonale'', pas studimit dhe konsultimeve me Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administata e Zonës së Mbrojtur, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojnë dhe të marrinë masa për kremtimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqetë re nëpunën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

INCA e ftuar në panairet IPA

Shkodër - Korçë - Shkurt 2016 *- INCA ka qënë e ftuar në panairen e Projekteve IPA CBC 2007-2013 Mali i Zi-Shqipëri dhe Greqi-Shqipëri të organizuara në Shkodër dhe Korçë gjatë muajit Shkurt.*

Stendat e INCA me projektet "Të shpallim liqenin e Shkodrës si një Rezervë e Biosferës së UNESCO-s" dhe "Ekomuzeumi i lumit Vjosa-Aoos" vizitohen me interes nga Ministria e Integrimit znj. Gjosha, Ambasadorët e Republikës Greke dhe asaj të Malit të Zi në Shqipëri, përfaqësues të Delegacionit të EU në Tiranë si dhe të ftuar të tjerë të cilët kanë vlerësuar projektet e zbatuara nga INCA si nga më të suksesshmit.

Vazhdon proçesi i zonimit të Liqenit të Shkodrës

Shkodër, 11 Mars 2016 – E ardhmja e qëndrueshme e liqenit të Shkodrës, kufi natyror midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, varet nga veprimet e koordinuara të të dy vendeve. Zyra e IUCN për Evropën Juglindore po bashkëpunon me INCA-n dhe Green Home në Malin e Zi, Ministrinë e Mjedisit si dhe me autoritetet e zonave të mbrojtura dhe ruajtjes së natyrës për të punuar për menaxhimin efektiv të biodiversitetit në këtë liqen.

Si liqeni më i madh në Ballkan, liqeni i Shkodrës ka parë një sërë marrëveshjesh politike për përmirësimin e menaxhimit dhe mbështetjen e përpjekjeve ndërkombëtare për ruajtjen e tij. Pavarësisht vlerave të jashtëzakonshme të tij, kjo

zonë përballet ende me probleme si menaxhimi i dobët i biodiversitetit dhe vlerave natyrore, urbanizimi i pakontrolluar dhe ndërtimet e paligjshme, gjuetia pa leje dhe shqetësimi i llojeve të egra.

"Qëllimi i IUCN është të krijoje një rrjet që të bashkoje aktoret nga Shqipëria dhe Mali i Zi dhe të mbështesë punën e tyre për menaxhimin e qëndrueshëm të liqenit të Shkodrës". "Përdorimi i mençur i biodiversitetit të liqenit do të garantojë zhvillimin e ekonomisë lokale dhe ruajtjen e vlerave dhe burimeve natyrore kësaj zone të mbrojtur për brezat e ardhshëm".

Ky aksion i përbashkët mbështetet nga Fondi i Partneritetit për Ekosistemet Kritike dhe synon të forcojë zbatimin e ligjit, të nxisë pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e biodiversitetit midis aktorëve kryesore dhe menaxhereve të burimeve natyrore. Partneret do të punojnë ngushtësisht me Ndërmarrjen Publike të Parqeve Kombëtare në Mal të Zi – autoriteti i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Liqenit të Shkodrës, dhe Administratën Rajonale te Zonave të Mbrojtura Shkodër.

Me një sipërfaqe prej 5,490 km², liqeni i Shkodrës është më i madhi në Ballkan. Ai ka një diversitet të larte të bimëve dhe kafshëve duke numëruar 930 lloje algash, 497 bime enëzore, dhe 430 lloje zooplanktoni dhe mikrofaune. Për

Vijon në faqe 4

Vijon nga faqe 3

këto vlera të larta të biodiversitetit, ky liqen gëzon një sërë statusesh ruajtjeje kombëtare dhe ndërkombëtare – në Malin e Zi ka statusin e Parkut Kombëtar ndërsa në Shqipëri atë të Rezervës Natyrore të Menaxhuar. Në nivel ndërkombëtar ai është shpallur si zonë Ramsar, zonë Emerald dhe Zonë e Rëndësishme për Shpendët dhe Bimët.

Aktualisht ka përfunduar proçesi i rizonimit të liqenit të Shkodrës, dhe puna po vazhdon me konsultimet publike sipas grupeve të interesit. Takimi në Shkodër ka për qëllim të ndajë me komunitetitn e pashekatarëve rishikimin e zonës në sensin e mirëmenaxhimit të burimeve natyrore kyresisht të rezervave peshkore. Aktivitetet e lejuara dhe jo të lejuara sipas zonave dhe nënzonave të propozuara. Takimi i sotëm organizohet me peshkatarët për të marrë mendimin e tyre në lidhje me këtë proces si një ndër aktorët kryesorë përfitues të aktiviteteve ekonomike nga peshkimi. Me këtë rast vlen të nënvizohet bashkëpunimi i suksesshem midis INCA, AdZM dhe OMP Shkodër në drejtim të ruajtjes së vlerave dhe zbatimit të legjislacionit, ndërgjegjesimit të peshkatareve por edhe aktoreve të tjerë për domosdoshmërine e forcimit dhe përmirësimit të menaxhimit të këtij rezervati natyror të menaxhuar duke ndërmarrë edhe aktivtete ndërgjegjësimi dhe promovimi duke përfshirë edhe komunitetin e mësuesve, nxenesve dhe prindërve të zonës.

Një ditë në Parkun tim !

Vlorë, Mars 2016 – Një tjetër komponent i projektit "Aktivitete të Qëndrueshme Ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut-Karaburun-Sazan" është edhe ai i edukimit. Programi i edukimit është konceptuar të mbështet në parimin e "interpretimit" dhe të zbatohet në tre faza kryesore. Ky program zbatohet për herë të parë në këtë zonë dhe ka fokus kryesor trajnimin e stafit të AdZM mbi edukimin e vlerave të parkut në brezin e ri dhe demonstrimin e këtij programi me fëmijët e shkollave.

Vijon në faqe 6

Vijon nga faqe 5

Teknika e edukimit nëpërmjet

interpretimit është një teknikë relativisht e vjetër, e përdorur gjerësisht në parqet kombëtare në USA, e cila me vonë është huazuar në të gjithë botën. Kjo teknike përdoret nga rojet e parqeve dhe stafi përgjegjës për edukimin, për të zbuluar dhe interpretuar kuptimin e vlerat natyrore dhe historike të parqeve dhe për ti përkthyer ato në një gjuhë që të gjithë vizitorët mund të kuptojnë.

Kjo mënyrë e transmetimit të vlerave ndihmon vizitorët të të gjitha moshave të zbulojnë, kuptojnë dhe krijojnë një lidhje personale me vlerat e parkut. Teknika e edukimit nëpërmjet interpretimit është konsideruar veçanërisht interesante për t'u zbatuar në Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan, ku mbi të gjitha deri tani kanë munguar programet e edukimit të mirëfillt të zbatuara nga administrata dhe aktorë të tjerë për ketë zonë.

Programi i edukimit nëpërmjet interpretimit në Parkun Detar Kombëtar, mbështet mbi parimin e "gjithëpërfshirjes", si një prej principeve kryesore të kësaj teknike. Programi vendos në fokus Parkun Detar Kombëtar me vlerat natyrore dhe historike të tij, speciet dhe rëndësinë e ekosistemeve duke përfshire edhe zonat përreth, Parkun Arkeologjik të Orikut, Lagunën e Orikumit dhe Qendrën e Peshkimit dhe Aktiviteteve Eko

Vëzhgoni dhe Mësoni Natyrën Tonë
Vëzhgoni dhe Mësoni Natyrën Tonë
Vëzhgoni dhe Mësoni Natyrën Tonë

Vijon nga faqe 6

planifikuar të zbatohet në tre faza

kryesore, trajnimi i stafit të AdZM Vlorë, zbatimi në terren me fëmijët e shkollës 9-vjeçare "Balil Pelari", Orikum dhe stafin e AdZM Vlorë dhe zhvillimi i ekspozitës me krijimet e fëmijëve. Përgatitja e përmbajtjes së programit është bërë në bashkëpunim me stafin e administratës dhe ekspertët e edukimit pranë INCA.

Në datë 21 Mars 2016, pranë zyrave të AdZM

Vlorë, INCA zhvilloi trajnimin "Hyrje në Interpretim" me stafin e AdZM mbi teknikat e edukimit nëpërmjet interpretimit, udhëzime praktike dhe mënyrën sesi këto teknika mund të përshtaten në Parkun Kombëtar Detar Karaburun -Sazan. Ky trajnim ishte një fazë përgatitore për të rritur performancën për stafin jo vetëm gjatë ekskursionit në zonë, por edhe për të ardhmen.

Ndërsa në datë 29 Mars, INCA dhe AdZM Vlorë, në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare "Balil Pelari", Orikum, zhvilloi ekskursionin e me teme "Një Dite në Parkun Tim!" me rreth 40 nxënës të kësaj shkolle. Gjatë ekskursionit ishin rojet e parkut ata që drejtuan ekskursionin dhe patën rolin kryesor. Rojet u treguan fëmijëve rreth punës se tyre, vlerave të parkut dhe zonave përreth në bashkëpunim me arkeologun dhe operatorin turistik. Misioni i fëmijëve në këtë ditë ishte të angazhoheshin në vlerësimin e zonës nëpërmjet punimeve artistike, bazuar në tregimin

rojeve. Gjatë ekskursionit fëmijët u ndalën në tre pika kryesore, në Parkun Arkeologjik të Orikut, Lagunën e Orikumit dhe Qendrën e Peshkimit dhe Eko Turizmit Radhimë. Në çdo pikë rojet dhe stafi i AdZM treguan për zonën, historinë e saj, vlerat natyrore, speciet dhe eksositemin, duke i komunikuar ato me terma të thjeshtë dhe në mënyre interaktive.

Vijon në faqe 8

Vijon nga faqe 7

Në fund të muajit Prill, do të zhvillohet një ekspozitë me punët artistike të nxënësve, me pjesëmarrjen e stafit të AdZM, prindërve, mëuesve të shkollës, përfaqësues të Njësisë Administrative Orikum etj.

Mbahet në Shkodër Forumi i hapur qytetar

Shkodër 1 Mars 2016 – Përfitimet dhe Shërbimet e Ekosistemeve Ligatinore ka qenë tema e forumit qytetar mbajtur në Shkodër me 1 Mars 2016. Ky forum mblodhi se bashku banorët e zonave Zogaj, Shirokë, Oblikë dhe Muriqan përfshirë këtu grupet e interesit që përfitojnë nga burimet natyrore të ekosistemit ligatinor Liqeni i Shkodrës – Lumi Buna & Laguna e Vilunit.

Forumi i hapur me bazë komunitare ishte i pari i këtij lloji për të evidentuar dhe prurë sa më afër informacionin që lidhet me shërbimet e ekosistemeve. Në këtë forum morën pjesë N/ Kryetari i Bashkisë Shkodër z. Arben Gjuraj, sekretarja e përgjithshme e Prefekturës Shkodër znj. Felek Brahimi, Kryeinspektori i Inspektoriatit Shtetëror të Mbrojtjes e Mjedisit z. Edmond Tërthorja, përfaqësues të ARM, Drejtorisë së Pyjeve, shoqatave mjedisore si dhe ekspert të universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Forumi i parë për çështjet e shërbimeve ndaj ekosistemit Liqeni i Shkodrës u mbajt në kuadër të projektit "Veprimtari lokale për mbrojtjen e llojshmërisë biologjike drejt zhvillimin të qëndrueshëm" mbështetur me fondet e Bashkimit Evropian përmes programit EcoNord.

Takimi u organizua nga FORUMI Shqiptar Liqeni i Shkodrës me qëllim krijimin e interesit më të madh, ndërgjegjësimin e komunitetit dhe shoqërisë civile për shërbimet ndaj ekosistemit si dhe të kuptuarit më të drejtë të lidhjes midis biodiversitetit dhe shërbimeve lokale të ekosistemit.

Projekti në fjalë është një platformë e re e bashkëpunimi mes bashkisë Shkodër dhe FSLS me qëllim forcimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët. FORUMI Shqiptar Liqeni i Shkodrës zbaton këtë projekt në partneritet me Bashkinë Shkodër dhe në bashkëpunim të ngushtë me Agjencitë përgjegjëse për Zonat e Mbrojtura, Agjencinë Rajonale të Mjedisit dhe Inspektoriatin Shtetëror të Mbrojtjes së Mjedisit.

Nga Mahir Hoti
Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës

Pyjet, pemët dhe shëndeti i njeriut

21 Marsi, është shpallur "Dita Ndërkombëtare e Pyjeve (IDF) nga Asambleja e Përgjithëshme e Kombeve të Bashkuara (OKB) që në vitin 2011 – Viti Botëror i Pyjeve . Në "Ditën Ndërkombëtare të Pyjeve", vendet e botës inkurajohen të ndërmarrin nisma, të organizojnë ativitete që përfshijnë pyjet dhe drurët pyjor, të organizojnë fushata për mbjelljen e pemëve, të punohet për të rritur informimin dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e këtyre ekosistemeve.

Pyjet dhe uji, është tematika kryesore e "Ditës Ndërkombëtare të Pyjeve në vitin 2016". Synohet që të nxirret më në pah roli i pazëvendësueshëm i pyjeve; për mbrojtjen shtimin dhe cilësinë ujit në planet.

Lidhja midis jetesës moderne me nivelet në rritje të sëmundjeve kronike; të zemrës, obeziteti, stresi dhe shëndetit të dobët mendor është një shqetësim në të gjithë botën. Kostoja që kanë të bëjnë me këto sëmundje është një barrë e madhe në buxhetet kombëtare të shëndetit publik të gjitha vendeve. Në përmirësim të kësaj gjendje, politikë bërësit gjithnjë janë duke kërkuar alternativa në parandalimin si një investim me kosto më të ulët dhe si trajtim mjeksor me efektiv. Vëmendja është kthyer drejt bashkëveprimit në mes të mjedisit dhe mënyrës së jetesës. Faktorët kryesore që po e krijojnë këtë gjëndje identifikohen si; një popullsi ku mundësia për punësim zvoglohet; rritje e nivelit të stresit mendor që lidhet me jetën urbane, zhvillim i veprimtarive në mjedise të ndotura dhe shpesh të rrezikshme, etj. Në parandalim dhe përmirësim të gjendjes, si "terapia" më e mirë konsiderohet Natyra. Hapësirat dhe elementet natyrore si; drurët e veçuara apo dhe ato që formojnë pyjet, konsiderohën sot si mundësia më e mirë për të përmirësuar këto probleme shëndetësore.

Pyjet dhe pemët në shumë mënyra, kontribuojnë për në mjedis të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm të jetesës, për shëndetin individual dhe publik. Drurët pyjor, kanë një potencial për të rivendosur ekosistemet e degraduara, për të siguruar ushqim, produkte mjekësore dhe mallra të tjera që kontribuojnë në shëndetin e njeriut. Vetëm pyjet mundësojnë shërbime mjedisore si: mbrojtje nga rrezatimi diellor, mbrojtjen e ajrit nga ndotja, mbrojtje nga erërat dhe zhurma. Vetëm mjedisi pyjor arrin të krijojë një mikroklimë të përshtateshme për njerëzit dhe faunën, mbrojtjen e burimeve ujore dhe të pjellorisë së tokës, parandalimin e erozionit të tokës, zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Pyjet dhe pemë konsiderohen sot si mjeti më i mirë; për të luftuar stresin e qenieve njerëzore, për të përmirësuar mirëqenien psikologjike, në proceset e shërimit me shpejtësi dhe rritje të kapacitetit mendor. Për vendet në zhvillim, konsiderimi i pyjeve si një ndër elementet kryesorë të zhvillimit, shërben si mjet i fuqishëm për të ndaluar mbi popullimin e zonave urbane. Pyjet urbane shërbejnë fuqishëm për të mbrojtur burimet e ujit të pijshëm dhe ndotjen nga ujërat e zeza. Në mjedise urbane me sipërfaqe të pjerreta, janë mjeti më i rëndësishem në kontrollin e erozionit dhe të rreshqitjeve të tokës.

Rekreacioni në natyrë është bërë një element i rëndësishëm i një jete të shëndetshme; ilaçi më i mirë kundër një "jete moderne" të ndarë nga natyra. Pyjet dhe pemët janë të lidhura me kapacitetet e punës së njerëzve me veprimtarinë shoqërore dhe pjesëmarrjen sociale, mundësojnë stil të jetës ekologjikisht të qëndrueshme. Njerëzit me nevoja të veçanta të tilla si; të moshuarit, femijët ose ata me aftësi të

Vijon në faqe 10

Vijon nga faqe 9

kufizuara fizike apo mendore; i kanë të domosdoshme veprimtaritë në mjedise natyrore me pyje. Pyjet, sigurojnë parametrat për ushtrime fizike që sjellin efekte pozitive shëndetësore tek të gjitha kategoritë dhe moshat e njerëzve.

Rolit shoqëror të pyjeve, deri tani s'fundi, i është dhënë pak vëmendje dhe në politikën ndërkombëtare, ndërkohë ai rol meriton dhe po merr një vlerësim më të madh. Studimet mbi ndikimin e pyjeve dhe pemëve në shëndetin dhe mirëqenien e njeriut, deri tani kanë qënë të kufizuara. Shëndeti i njeriut nuk është vleresuar si komponent i rëndësishme në dimensionin social të pylltarisë. Nga viti 2013 studimet në këtë fushë kanë qënë të mëdha dhe kanë filluar të pubkikohen rezultatet e gjetura.

Shëndeti dhe mjedisi janë të lidhura ngushtë me çdo profesion, kërkimet shkencore dhe palët e interesuara në këtë fushë po rriten. Përvoja shkencore dhe të kuptuarit në këtë fushë kërkon bashkëpunimin midis studiuesve në shëndetësi, mjedis dhe shkenca sociale, si dhe përfshirjen e ngushtë të agjencive të zbatimit. Nga menaxherët e pyjeve kërkohet; të njohin, të inkurajojne dhe promovojnë praktikisht për publikun kontributin e madh të pyjeve në shëndetin mendor të popullsisë, krahas efekteve mjedisore. Në mënyrë të ngjashme në punën e tyre, profesionistë e shëndetit dhe planifikuesit urban duhet t'i kushtojnë vëmendje efekteve shëndetësore, në promovimin funksioneve të pazevendësueshme për shendetin e komunitetit i pemëve dhe e pyjeve urban.

Profesionistët e pyjeve, ata shëndetësor dhe planifikuesit urban; duhet të marrin përsipër edhe të kenë fokus kryesore; rolin pyjeve urban në shëndetin e njeriut: Vendosja e dialogut, partneritetit dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet aktorëve të ndryshëm që lidhen me pyjet; shëndetin e njeriut dhe mirëqenien; shkencëtarët nga disiplina të ndryshme (p.sh. shëndetësi, pylltari, mjedis, shkencat sociale) politikë bërësve, agjencive kërkimore e zbatuese and research financiers, by eg organizing meetings, workshops or conferences and improving the networking of the stakeholders . dhe financuesve; merr rëndësi dhe ka rol të veçantë, jo vetën për ditet e sotme, por për perspektivën e rolit të pazëvëndesueshëm të pyllit në shendetin e njerëzve.

Nga Gjon Fierza
Agjencia Kombëtare e Mjedisit

NJOFTIME

7 Prill - Dita Botërore e Shëndetit
22 Prill - Dita e Tokës (Planetit)
24 Prill - Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve Laboratorike

1 - According to a recent study by Riverwatch, over 2000 new hydropower plants are being planned in the Balkan region. The entire river system in Albania is un der severe threat, stemming largely from a lack of strategic planning, inadequate impact assessments, improper public consultations and lack of transparency. In response, WWF and local partners recently issued a hydropower moratorium ini tiative. Riverwalk 2016 would draw attention to the situation and support the pro tection of wild rivers. The Valbona river (this river is the heart of Valbona Valley national park and yet, there are plans for four new hydropower plants) was se lected as the perfect location for the next Riverwalk!
http://www.theguardian.com/environment/2015/feb/20/balkan-dam-boom- threat ens-europes-last-wild-waterways

2 - Turi i Lumenjve të Ballkanit / Lumi Osum (Shqipëri), 10-12 Maj 2016

Lumi i Osumit mendohet të jetë krijuar 2-3 milion vjet më parë. Ai ka kanionin më të madh në Shqipëri dhe shihet nga shumë gjeografë dhe kërkues evropian si një nga më të mëdhenjtë në Evropë. Rreziku më i madh i lumit Osum është plani i qeverisë shqiptare për të ndërtuar në kaskadë tetë hidrocentrale.

Ndërtimi i tetë digave përgjatë Osumit do të ndryshojë rrjedhën e lumit dhe peizazhin e bukur të kanionit. Kjo do të rrezikojë speciet e peshqve autoktone dhe turizmin e aventurës që është zhvilluar kohët e fundit përgjatë lumit. WWF dhe INCA janë aktive në Shqipëri për mbrojtjen e lumenjve kundrejt zhvillimit të paqëndrueshëm të hidrocentraleve dhe Osumi është një simbol i kësaj përpjekje.

Së bashku me disa partnerë, WWF dhe INCA kanë kërkuar që qeveria shqiptare të deklarojë moratorium për digat, duke vendosur që të gjitha projektet e hidrocentraleve të ndalohen për një periudhë tre vjeçare derisa një kuadër më i rreptë i vendimmarrjes të vendoset në përputhje me legjislacionin e BE.

Programi

Në 10 maj, kajakër do të arrijnë në Çorovodë në Shqipëri. Për dy ditë kajakër do të eksplorojnë kanionin e Osumit. Së bashku me OSHC lokale (INCA, Outdoor Albania, Toros, Albanian Rafting) WWF do të organizojë aktivitete në mbrëmje në kamp: Dokumentari i Vjosës "One for the River – the Vjosa Story" në mbrëmjen e parë dhe DamNation në të dytën.

E Martë, 10 Maj – Arritja në qendrën e rafting Çorovodë. Shikim të dokumentarit të Vjosës "One for the River – the Vjosa Story" në mbrëmje

E Mërkurë, 11Maj – Aktivitetet e Ditës

10:00h Fillon nga Çorovoda: vozitje në kanionin e Osumit

13:00h Takimi në kamp dhe piknik me pjesëmarrësit

19:00h Shikimi i dokumentarit DamNation + diskutime dhe darkë

E Enjte, 12Maj – Aktivitetet e Ditës

10:00h Fillon nga Çorovoda: vozitje në kanionin e Osumit

16:00h Kthim në kamp dhe kohë e lirë

Pjesëmarrësit do të qëndrojnë në zonën e kampit në Çorovodë.

Kontaktet: Bojan Stojanović, bstojanovic@wwfadria.org, +385 95 2567 780
Emirjeta Adhami, emirjeta.adhami@inca-al.org, +355 68 2062 157

3 - Për të lexuar **"*Ditari i Natyrës*"** në vite…
http://www.inca-al.org/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=15&Itemid=195&lang=sq

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.
Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, 1001, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania